

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtares Mevlide Shabani, me sekretaren juridike Hyrije Sylejmani, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit S. F, nga fsh. Zh, K. Gj, kundër të paditurve I, S dhe Q. Rr, që të gjithë nga fsh. Zh K. Gj, baza e kontestit vërtetim i pronësisë, në shqyrtimin e mbajtur kryesor më datë.09.06.2017 , bie këtë

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET kërkesëpadia e paditësit S. F, nga fsh. Zh, e paraqitur kundër të paditurve I, S dhe Q. Rr që të gjithë nga fsh. Zh dhe **VËRTETOHËT** se paditësi në bazë të marrveshjes mbi ndrrimin e parcelave është pronar i ngastr.kadastrale me nr.te njësis....., në sipërfaqe prej.., e cila gjindet në vendin e quajtur V, e evidentuar në emër të Xh. Rr. ZK. Zh, e cila evidentohet në Çertifikaten me nr., të dat....

II.OBLIGOHEN të paditurit I, S dhe Q. Rr që të gjithë nga fsh. Zh që këtë të drejtë të ia njoh paditësit dhe të përmbahen e durojnë që paditësi këtë palujtshmëri ta regjistrojnë në emër të tijë në librat kadastrale në Drejtorin për Gjeodezi Kadastër dhe pronë në Gjilan, këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, S. F nga fsh. Zh, në padi, kërkes padi dhe në shqyrtimin e mbajtur kryesor ka konfirmuar se në vitin 1978, ka lidhur një marrveshje gojore mbi ndrrimin e palujtshmërive me paraardhësit e paditësve tani të ndjerë F dhe R Rri, e cila ishte lidhur me vullnet dhe mirëkuptim lidhur me palujtshmërin për njësin kadastr.01969-0.

Shqyrtimi gjyqësor i datës 09.06. 2017, është mbajtur në munges të të paditurit Skender Rrustemi e me propozimin e paditësit, pasi që i njëjti ka qenë i ftuar në mënyr të rregullt, ndërsa të paditurit , nuk e kanë kontestuar kërkesën e paditësit .

Paditësi S. F ka mbetur në tersi pranë padis dhe kërkespadis, si dhe precizimit me anë të parashtresës së dat.25.09.2014. ka shtuar se në gjykatë i ka sjellur edhe dy dëshmitar M. F nga fsh. Zheger dhe F. M nga fsh. Zh, që të deklarohen lidhur me këtë qështje duke shtuar se të paditurit para se të hyjnë në seancë e kan njoftuar se nuk ia kontestojnë kërkesëpadin.

Të paditurit I dhe Q. Rr nga fsh. Zh që të dy bashkarisht kanë deklaruar se nuk e kontestojnë padinë e paditësit duke shtuar se janë mare vesh edhe me vëllaun e tyre Skenderin që për shkaqe personale nuk gjindet në seancë dhe duke u deklaruar nën betim i propozojn gjykatës që të bie aktgjykim në bazë të pranimit. Kanë shtuar se me paditësin janë kusherinjë dhe palujtshmerit kufizohen në mëgje, e që paditësi nga babai

i tyre tani i ndjerë në vitin 1978 , me anë të marrveshjes gojore kishte bërë ndrrimin e parcelave dhe tani në parcelën kontestuese kishte ndërtuar edhe shtepin e banimit , e të cilën parcel edhe sod e shfrytëzon në mënyr të qetë e të pa penguar.

Pas dëgjimit të deklaratve të palëve ndërgjyqëse, gjykata nuk e pa të arsyeshme të dëgjohen dëshmitarët e propozuar edhe pse të njëjtit ishin në gjykatë meqë propozimi i paditësve ishte të bihet aktgjykim në bazë të pranimit.

Gjykata i ka shtjelluar provat duke e lexuar qertifikatën mbi të drejtat e pronës me numër ...të dat.10.09.2014, , me nr. të njësis... Zh, zyra kasastrale Komunale në Gjilan.

Nga deklaratat e të paditurver, të cilët nuk e kontestuan kërkespadin e paditësit , u vërtetua se paditësi është posedues I ngastres kontestuese të cekur sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi, edhe ate në bazë të kontrates gojore mbi ndrrimin e palujtshmërive nga viti 1978, kur ishte bërë ndrrimi ashtu që paditësi kishte hyrë në shfrytëzim të së njëjtes , kishte ndertuar edhe shtepin e banimit ku edhe sod jeton, nuk është I penguar nga as kush e as nga ana e tani të paditurve.

Meqenëse në tërsi janë përmbushur prestacionet lidhur me këtë shitblerje, se paditësi gjendet në posedim dhe shfrytëzim të kësaj palujtëshmërie që nga viti 1978, janë plotësuar kushtet për fitimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues si që e parasheh dispozita e nenit 28 paragrafi 4 të LTHMPJ.

Nga të cekurat e në pajtim me dispozitën e nenit 36 të Ligjit mbi pronësisë dhe të drejtat tjera sendore , gjykata gjeti se kërkes padia e paditësit në tërsi është e bazuar, dhe si të këtillë e aprovoi.

Vendimi mbi shpenzimet nuk është marrë dhe është vendosur që secila pale ti bartë shpenzimet e veta kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Më dt.09 .06. 2017

Gjyqtarja
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtijë aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kesaje gjykate.*